



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "THOMA PAPAPANO", GJIROKASTËR

152/3
Nr. prot.

Gjirokastrë, më 24/09/2024

Lënda : Njoftim për vend të lirë pune

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të Ligjit Nr. 15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të agjencisë kombëtare të punësimit dhe aftësive", Udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional", si dhe Aspektet e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Përbërjes së Njësisë së Zhvillimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Zhvillimit të Vazhduar Profesional të Personelit", "Udhëzimin nr 26 ,date 22/09/2022 " Për disa ndryshime dhe shtesa ne Udhëzimin nr. 28, datë 14.10.2019, "Për Numrin e Nxënësve për Klasë dhe Normat e Punës Mësimore në Institucionet e Arsimit Profesional ", të Udhëzimit nr. 25, datë 01/09/2023 "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në Ofruesit e Arsimit Profesional", si dhe në mungesë të paraqitjes së kandidatëve për lëvizje paralele :

Shkolla e Mesme Profesionale : "Thoma Papapano", Gjirokastrë, ju njofton për krijimin e një vendit të lirë të punës me kohë të plotë , në pozicionin:

Mësues i Teorisë Profesionale ,në Drejtimin Mësimor "Shërbime në Mjete Transporti ",me kohë të plotë .

1.Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;

- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) Të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlefshme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së.
- b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dokumentet e aplikimit.

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) Letërmotivimin për pozicionin;
 - b) Jetëshkrimin (Cv-ne sipas shtojcës 11 të udhëzimit 14 dt. 27.05.2021).
 - c) Kartën e identitetit;
 - d) Diplomën;
 - e) Librezën e punës;
 - f) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet , trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
 - g) Certificatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
 - h) Vërtetimin e gjëndjes shëndetësore;
 - i) Vërtetimin e gjëndjes gjyqësore;
 - j) Vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
 - k) Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.
 - l) Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;
1. Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.
 2. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së brenda datës 07.10.2024

DREJTOR

Renata Puleri

